STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 8 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE LIRR DO TE FUNKSIONOJE ME SHERBIM TE PLOTE NE ORET E PIKUT TE MENGJESIT DHE TE PASDITES DUKE FILLUAR TE HENEN PASI AMTRAK RESTAURON NJE NGA DY TUNELET E DEMTUAR NGA PERMBYTJA

Amtrak pritet të zëvendësojë sistemin e sinjaleve në tunelin e dytë të dëmtuar fundjavën e ardhshme, duke siguruar kapacitet të plotë në të dy tunelet e dëmtuar gjatë super stuhisë Sendi (Sandy)

Ekipet e sinjaleve të LIRR ndihmojnë Amtrak në lidhjen e kutive të sinjaleve për të rivendosur shërbimin e plotë të LIRR

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Hekurudha e Long Ajlënd (Long Island) e MTA do të funksionojë me shërbim të plotë në orët e pikut të mëngjesit dhe të pasdites duke filluar të hënën, 10 dhjetor, si rezultat i restaurimit nga Amtrak të kapacitetit së sinjaleve të sistemit në një nga dy tunelet e tij të Lumit Lindor (East River) të dëmtuar nga përmbytja. Kjo do të shënojë orët e para të pikut me shërbim të plotë për LIRR që kur Sendi (Sandy) goditi gjashtë javë më parë.

Në zëvendësimin e sistemit të sinjaleve të dëmtuar rëndë në një nga tunelet, të kombinuar me një rritje të shpejtësisë në një shinë unazë që lidh tunelet e Lumit Lindor (East River) me kantierin e magazinimit Sanisajd (Sunnyside), Amtrak restauroi kapacitet të mjaftueshëm të trenave për të lejuar për rritjen e nivelit të shërbimit të LIRR gjatë orëve të pikut. Amtrak vazhdon punën e tij për të zëvendësuar sistemin e dëmtuar të sinjaleve në tunelin tjetër të mbetur, për të rivendosur kapacitetin e plotë të trenave në tunelet e tij të Lumit Lindor (East River). Punëtorët e sinjaleve të LIRR janë duke ndihmuar Amtrak në atë përpjekje, duke rilidhur pesë kuti të reja të sinjaleve të Amtrak për tunelet. Sistemi i sinjaleve i tunelit të dytë pritet të rivendoset në kapacitetet të plotë në kohë për festat e Krishtlindjes.

Shërbimi i LIRR jashtë pikut vazhdon të funksionojë me një grafik të rregullt anembanë sistemit të LIRR – edhe ndërsa një nga tunelet e dëmtuar të Amtrak është ende me kapacitet të pakësuar.

“Rivendosja e shërbimit të plotë të trenave të LIRR në orët e pikut do të sigurojë lehtësim për ata udhëtarë që përjetuan kushte të tejmbushjes gjatë periudhave të pikut për shkak të humbjes së kapacitetit të tunelit nga pasojat e përmbytjes të super stuhisë Sendi (Sandy),” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Dëshiroj të vlerësoj përpjekjet e Hekurudhës së Long Ajlënd (Long Island) dhe Amtrak në rivendosjen e këtij shërbimi vendimtar të LIRR.”

“Vlerësoj përpjekjet e Amtrak për të përshpejtuar punën në tunel për të rivendosur kapacitetin e plotë të trenave në tunelet e Lumit Lindor (East River) deri në festat e Krishtlindjes. Dhe dëshiroj të falënderoj burrat dhe gratë e LIRR që punuan pa pushim për të rikthyer shërbimin,” tha Kryetari dhe CEO i MTA Jozef J. Lota (Joseph J. Lhota).

“Kemi punuar nga afër me Amtrak për të përfunduar punën dhe për të gjetur zgjidhje krijuese për të rikthyer shërbimin e plotë të LIRR sa më shpejt që të jetë e mundur. Vlerësoj durimin e udhëtarëve tanë gjatë kësaj pune të restaurimit jetësor pas shkatërrimit të super stuhisë Sendi (Sandy),” tha Presidentja e LIRR Helena Uilliams (Helena Williams).

Në rikthimin e një nga dy tuneleve të dëmtuar në shërbimin e plotë, Amtrak zëvendësoi të gjitha kutitë e sistemit të sinjaleve, përfshirë pjesët dhe të gjitha lidhjet e ndërlikuara brenda kutive që ishin shkatërruar nga ujrat e përmbytjes. Instalimi i kutive të reja të sinjaleve në tunel kërkoi gjithashtu që në tunele të vendosen kabllo të reja të kontrollit të sinjaleve. Kalimi në sistemin e ri të sinjaleve të Amtrak këtë fundjavën e kaluar, e kombinuar me rregullimin e shpejtësisë në shinat që lidhin tunelet e Lumit Lindor (East River) me kantierin e tyre të magazinimit Sanisajd (Sunnyside) lejon që shërbimi gjatë orëve të pikut i të gjitha trenave të LIRR të rivendoset. (Kapaciteti i pakësuar mbetet në një nga tunelet e Lumit Lindor (East River) të Amtrak, gjë që ul fleksibilitetin e përdorimit të LIRR gjatë orëve të pikut në rastin e një ndërprerje.)

Amtrak është duke vazhduar punën e tij për të bërë riparime të përhershme në sistemin e sinjaleve në tunelin e mbetur të dëmtuar nga përmbytja. Amtrak do të instalojë tre kuti të reja të sinjaleve për sistemin e ri të përhershëm të sinjaleve. Nga nga kutitë e sinjaleve u lidh nga personeli i sinjaleve i LIRR në mjedisin e Gardën Siti (Garden City) të LIRR. Kjo pajisje e re e sinjaleve pritet të instalohet dhe të provohet gjatë fundjavës së 15-16 dhjetorit, në mënyrë që kapaciteti i plotë i trenave në tunelet e Lumit Lindor (East River) të mund të rivendoset deri në festën e Krishtlindjeve.

Për informacion mbi shërbimin e LIRR
Udhëtarët duhet të vëzhgojnë njoftimet e lajmeve, faqen në internet të MTA, www.mta.info, dhe të rregjistrohen për E-Alerts falas (free E-Alerts) për azhornime të shërbimit të LIRR. Udhëtarët gjithashtu mund të kontaktojnë Qendrën e Informacionit për Udhëtim të LIIR duke telefonuar në 511, Linjën e Informacionit për Udhëtim të Shtetit të Nju Jorkut (New York State) dhe të thonë: Long Ajlënd Reill Roud (Long Island Rail Road). Nëse jeni shurdh ose keni vështirësi të dëgjimit, përdorni siguruesin tuaj të preferuar të shërbimit me rele për relenë falas 711 për të kontaktuar me LIRR në 511.

###